

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare - Konferencë Kombëtare
“SFIDAT E ZHVILLIMIT TË TREGJEVE NËN MBIKËQYRJEN
E AMF-SË DHE EDUKIMI FINANCIAR”
24 Maj 2018 - Tiranë, Shqipëri

BURSA DHE FAKTORËT QË NDIKOJNË NË FUNKSIONIMIN E SAJ

Sara DINO¹
Sara HAKCANI²
Bleona SINAJ³

Abstrakt

Bursa është një vend ku shoqëri aksionare, ndërmarrje dhe firma të ndryshme private drejtohen për të ngritur fondin e investimeve dhe siguruar kapitalet e tyre. Bursat janë një vend real ku shitësit dhe blerësit e letrave me vlerë takohen për të kryer transaksione të ndryshme. Bursa nënkupton kryerjen e transaksioneve brenda një mjedisi. Në çdo vend të botës ka kompani ku është e mundur që të bëhen investime në bursa. Madje dhe në vendet afrikane ku zhvillimi ekonomik ecën me ritme më të ngadalta. Shqipëria është një vend pa eksperiencë në këtë aspekt. Informacioni rreth bursës në Shqipëri ka qenë i pakët. Pothuajse termi “Bursë” nuk njihet, por kohët e fundit ka filluar të marrë një zhvillim me hapa të mëdhenj. Bursa është një element i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe financiar të vendit, sepse është një alternativë shumë konkurruese e sektorit bankar duke ulur koston e ndërmjetësimin për bizneset dhe për të gjithë operatorët ekonomikë. Bizneset nuk mund t’i plotësojnë të gjitha nevojat e financimit për sistemin bankar, ndërsa, nga ana tjetër janë edhe individët, që në këtë moment nuk kanë shumë alternativa për të investuar kursimet e tyre. Investimi në tituj qeveritar është një alternativë tjetër investimi.

Aktualisht ka qenë i zhvilluar vetëm tregu primar (pra, ankandet që zhvillohen pranë Bankës së Shqipërisë) ndërsa tregu sekondar për këto tituj ka qenë më pak i zhvilluar, për shkak se individët mbajtës të këtyre letrave me vlerë e kanë pasur të vështirë kthimin e tyre në likuiditet, sepse në rast nevojë duhet të pranonin çmimin që u jep banka e tyre. Nga ana tjetër po të shikoni të dhënat që ndodhen në Bankën e Shqipërisë dhe interesin e këtyre titujve, krahasuar me depozitat bankare është disa fish më e lartë. Në qoftë se bankat japin për një depozitë 1-vjeçare normë interesi në Lekë rreth 1-2%, ankandet për bono thesari 1-vjeçare kanë një normë kthimi 2-3%.

Për të gjitha këto arsye të listuara më lart, mendojmë që titujt qeveritarë dhe interesi që ato ofrojnë është shumë herë më i mirë se depozitat. Dhe nuk mund të vendoset si diçka negative që të shtyjnë të gjejshëm mënyra të tjera investimi alternative. Ato janë vetë një mënyrë investimi alternative dhe aktualisht bursa “ALSE” këto instrumente tregton. Problemi qëndron te likuiditeti (kthimi në çdo kohë në para). Ne besojmë se bursa do të sjellë një alternativë që individët mund t’i investojnë kursimet në aksionet apo titujt e tjerë të kompanive që do të jenë të interesuara për të tregtuar në vendin tonë.

Fjalë kyçe: *transaksion, bursë, investim, ndërmarrje, kapital.*

¹ Studente në “Universiteti Bujqësor i Tiranës”, sara.dino@live.com

² Studente në “Albanian University”, sarahakciani11@gmail.com

³ Studente në “Albanian University”, bleonasinaj13@gmail.com